

VENDIM
Nr. 433, datë 22.5.2013

PËR NJË RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013” dhe të ligjit nr. 10 122, datë 11.5.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për një financim shtesë për projektin e ofrimit të shërbimeve sociale”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin “Menaxhimi i sigurimeve shoqërore”, në kategorinë e shpenzimeve korente, i shtohet fondi prej 118 249 000 (njëqind e tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e nëntë mijë) lekësh.

2. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin “Sigurimi shoqëror” në kategorinë e shpenzimeve korente, i pakësohet fondi prej 118 249 000 (njëqind e tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e nëntë mijë) lekësh.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha